

**VENDIM**  
**Nr.939, datë 3.9.2009**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË TJERA TË STUDIMIT, PRANË SHKOLLËS SË  
LARTË UNIVERSITARE, PRIVATE “UNIVERSITY OF NEW YORK, TIRANA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, Tiranë në bashkëpunim me universitetin e Greenwich-it, Britania e Madhe, për hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, në formën e studimeve me kohë të plotë, në B.Sc, në “Inxhinieri të infrastrukturës së rrjeteve kompjuterike”, ekuivalente me “Diplomë e nivelit të parë”, (DNP), në “Inxhinieri të infrastrukturës së rrjeteve kompjuterike”.

2. Kohëzgjatja normale e këtij programi studimi, të ciklit të parë, të jetë 3 (tri) vite akademike, me plotësimin e 180 krediteve.

3. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, Tiranë, në bashkëpunim me universitetin Grenwinch-it, Britania e Madhe, për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë në:

a) Ll.M., në “E drejta ndërkombëtare dhe tregtare”, ekuivalente me “Diplomë e nivelit të dytë” (DND), në “E drejta ndërkombëtare dhe tregtare”;

b) M.Sc., në “Shkencat kompjuterike, ekuivalente me Diplomë e nivelit të dytë (DND), në Shkencat kompjuterike;

c) M.Sc., në “Financë dhe kontabilitet”, ekuivalente me “Diplomë e nivelit të dytë” (DND), në “Financë dhe kontabilitet”;

ç) M.A., në “Çështje (marrëdhënie) ndërkombëtare”, ekuivalente me “Diplomë e nivelit të dytë”, (DND), në “Çështje (marrëdhënie) ndërkombëtare”.

4. Kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimit të jetë, së paku, 1 (një) vit akademik, me plotësimin e së paku 60 krediteve. Në këto programe studimi do të pranohen kandidatët, që kanë fituar një diplomë, në përfundim të një programi studimi, të ciklit të parë, me kohëzgjatje normale 4 vite, me plotësimin e 240 krediteve, pas përshtatjes së studimeve, sipas Bolonjës, ose që zotërojnë një diplomë tjetër, ekuivalente me të.

5. Lejimin e shkollës së lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, Tiranë, për hapjen e programit të integruar të studimit të ciklit të dytë, në formën e studimeve me kohë të plotë për “Drejtësi”. Kohëzgjatja normale e këtij programi të jetë 5 vite, në plotësimin e 300 krediteve. Në përfundim të programit të studimit lëshohet “Diplomë e integruar e nivelit të dytë” (DIND), në “Drejtësi”.

6. Ngarkohet shkolla e lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, që, për çdo program studimi, pas vitit të parë të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

7. Shkolla e lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuar në këtë vendim, pasi të ketë marrë lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, por jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik.

Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet

e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

8. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

9. Shkolla e lartë universitare, private “University of New York, Tirana”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit të këtyre programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**